



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr.1446/7 prot.

Tiranë, më 23.12.2024

V E N D I M

Nr. 316, Datë 23. 12 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.210 Regj., datë 22.10.2024, e paraqitur nga znj. E. D., kundër dhe Shkollës 9-Vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin të djalit të saj të mitur E. D, për shkak të “gjendjes ekonomike”, “racës” dhe “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Quhem E. D. Jam nënë e një fëmije, i cili vazhdon arsimin 9-vjeçar pranë Shkollës “Pandeli Cale” dhe aktualisht është në klasën e 6-të.*”

Në muajin tetor, kam marrë një mesazh nga mësuesja kujdestare për të përgatitur dokumentacionin për përfitim të bursës në bazë të VKM 511, datë 27.07.2022, i ndryshuar. Kam shkuar për ta dorëzuar dokumentacionin në shkollë, por nuk më është pranuar, pasi shkolla kishte një rekomandim nga Drejtoria Mbështetëse që të pranohen dokumentet vetëm nga familjet që janë punëkërkuese të papunë dhe jo ato me ndihmë ekonomike. Unë marr 6,300 lek ndihmë ekonomike në muaj.

Problematika ime është përsëritur, pasi iu jam drejtuar edhe vitin e kaluar ju për të njëjtën çështje, ku akoma jemi në procedurë, edhe pse nuk ma ka ardhur përgjigja nga gjykata e cila hedh poshtë kërkesë-padinë e bashkisë dhe lë në fuqi vendimin tuaj. Po ju drejtohem si institucion që të më

zgjdhni problemin, pasi jam në vështirësi të madhe ekonomike. Gëzoj statusin e familjes në nevojë dhe jam punëkërkuese e papunë. Si mua janë dhe shumë familje të tjera që nuk po gjejnë zgjidhje për këtë situatë. Kur shteti rrit arsimimin e fëmijëve, na detyron të braktisim atë, pasi nuk kemi mundësi financiare.

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri, hetimin e rastit, konstatimin e diskriminimit dhe rekomandim për marrjen e bursës.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 210 Regj., datë 22.10.2024, të bërë nga znj. E. D, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1446/1 prot., datë 29.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shkresor nga ana e Shkollës 9-Vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, lidhur me veprimet e kryera prej saj, përsa i takon pretendimeve të subjektit ankues.
2. Me shkresën me nr. 85 prot., datë 01.11.2024¹, Shkolla 9-Vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë, ka njohur KMD-në në lidhje me pretendimet e pales ankuese, ku informon se: *Ankuesja, znj. E. D, nuk është paraqitur pranë drejtorisë së shkollës sonë për të dorëzuar dokumentacionin për përfitimin e bursës për djalin e saj, nxënësin E. D., Ajo është interesuar dhe është konsultuar për përgatitjen e dokumentacionit. Në këto takime, znj. E., ka pretenduar se ishte e vonuar për arsye që e pengonin të përfitonte bursën, dhe prandaj nuk po i përgatiste dokumentet, por ndërkohë ishte duke u kujdesur personalisht për të gjetur zgjidhje jashtë institucionit shkollor, për të cilin u shpreh me respekt dhe mirënjohje për kujdesin e treguar, veçanërisht nga anëtarët e drejtorisë së shkollës. Është krejtësisht i pavërtetë pretendimi i znj. E. D., se është diskriminuar nga institucioni ynë arsimor. Nuk ka ndodhur në asnjë rast dhe për asnjë arsye. Madje, edhe kur janë paraqitur vërtetime që tregonin përkatësinë e komunitetit egjiptian, të siguruara nga ndonjë shoqatë, ato nuk janë pranuar nga shkolla jonë, pasi është vlerësuar si i panevojshëm një dokument i tillë në një institucion arsimor gjithpërfshirës.*

Gjatë periudhës shtator - tetor, nxënësi E. D., nuk ka vijuar rregullisht në shkollë, por në interesimin tonë, znj. E. i është përgjigjur me justifikimin se djali i saj mungon për arsye shëndetësore. Ajo asnjëherë nuk ka pretenduar se janë arsye ekonomike ato që justifikojnë mungesat në shkollë të djalit të saj, E. D.

Institucioni ynë arsimor është aleat i bashkëpunimit dhe koordinimit të punës ndërinstitutional për shpalljen dhe bërëjen publike të kërkesave dhe kriterëve për përfitimin

¹ Administruar pranë Komisionerit me nr.1446/2 prot., datë 05.11.2024.

e bursës nga nxënësit që i përkasin kategorive të ndryshme; grumbullimit dhe dorëzimit të dokumentacionit për nxënësit përfitues, pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, e cila shqyrton dokumentacionin e dërguar prej nesh, dorazi, dhe vendos nëse është apo jo i rregullt ky dokumentacion përpara se të miratojë kërkesën e shkollës për nxënësin përfitues të bursës.

Në datën 3 tetor 2024, përmes postës elektronike, jemi njoftuar me email nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, se në bazë të hartës sociale për nxënësit e shkollës sonë dhe kriterëve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duhej të mblidhnim dokumentacionin e duhur për përfitimin e bursave nga nxënësit. Bashkangjitur në këtë email u dërgua edhe shkresa e Ministrisë së Arsimit, Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me Nr. 6016 prot., më 26/09/2024, drejtuar Bashkisë Korçë, "Për planifikimin e numrit të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar publik, për vitin shkollor 2024 - 2025."

Në datën 16 tetor 2024, përmes postës elektronike, jemi njoftuar me email nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, për dokumentat që duhen plotësuar dhe dorëzuar, bazuar në kriteret e përcaktuara për kategoritë e nxënësve përfitues të bursës.

Gjatë kësaj kohe, kemi kontaktuar vazhdimisht me NSHMAÇ dhe jemi sqaruar për raste të ndryshme dhe pretendime lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzonin të interesuarit e kategorisë "Fëmijë të familjeve në nevojë, të regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk mund ta ndjekin atë." Kemi kërkuar që prindër të nxënësve që vijnë nga familje në nevojë të dorëzojnë në shkollë dokumentacionin që vërteton arsyet financiare dhe domosdoshmërinë për të përfituar bursën, një ndër të cilat edhe vërtetimi që tregon se trajtohen apo nuk trajtohen me ndihmë ekonomike nga Bashkia. Institucioni ynë arsimor nuk ka kompetenca të vlerësojë mjaftueshmërinë apo pamjaftueshmërinë e vlerës në lekë të ndihmës ekonomike, që marrin familjet e nxënësve nga Bashkia e Korçës.

Së bashku me njoftimin për përgatitjen e dokumentacionit, mësueset kujdestare dhe drejtorja e shkollës kanë bërë të njohura kriteret për përfitimin e bursës, duke sqaruar në mënyrë të përsëritur me telefonata, mesazhe të shkruara dhe takime të drejtpërdrejta, secilin nga prindërit e nxënësve që pretendonin se plotësonin kriteret e dërguara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë.

Në datën 29 tetor 2024, pas kërkesës së dërguar me email në postën elektronike të shkollës, dërguam me email kërkesën e shkollës për nxënësit që kishin dorëzuar dokumentacionin për të qenë përfitues të bursës. Dosja me dokumentacionin e grumbulluar dhe kërkesën e shkollës për të shqyrtuar dhe miratuar listën e nxënësve përfitues të bursës, me Nr. 81 prot., u dorëzua dorazi në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, në datën 30 tetor 2024, si dhe në formatin e skanuar në postën elektronike, në datën 1/11/2024. Jemi në pritje të përgjigjes së Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, e cila, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, do të na njoftojë për të plotësuar databazën me të dhënat e nxënësve që do ta përfitojnë bursën për vitin shkollor 2024 - 2025.

3. Me shkresën me nr. 10194/1 prot., datë 01.11.2024², Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Manaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkisë Korçë, ka informuar KMD-në në kuadër të pretendimeve të ankueses.
4. Me shkresën me nr. 91 prot., datë 07.11.2024³, Shkolla 9-Vjeçare “Pandeli Cale”, Korçë, ka informuar KMD-në me qëndrimin dhe masat e ndërmarra prej saj në lidhje me pretendimet e ankueses, ku informon se: *Pasi u njohëm me njoftimin dhe kërkesën tuaj për informacion, të parashtruara në shkresat e dërguara nga ju, me Nr. 1446/1 prot., datë 29/10/2024; me Nr. 1470/1 prot., datë 29/10/2024; me Nr. 1447/1 prot., datë 30/10/2024, dhe në zbatim të kërkesës suaj për marrjen e masave të menjëhershme për pranimin e aplikimit/dokumentacionit të palëve, për përfitimin e bursës për fëmijët e mitur: A. D, D. D, E. D, R. Z, me qëllim parandalimin e cënimit të të drejtave dhe interesit të ligjshëm të palëve ankuese, ju informojmë se:*
 - *Institucioni ynë arsimor, në zbatim të rolit dhe funksionit si bashkëpunues për grumbullimin dhe dorëzimin e dokumentacionit për nxënësit që mund të jenë përfitues të bursës, duke plotësuar kriteret e njoftuara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, kërkoi nga palët ankuese dokumentacionin që ata kanë për aplikimin për bursë dhe e dërgoi atë me postë në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë.*
 - *Në shkresën shoqëruese i kërkuam NSHMAÇ që të marrë në konsideratë shqyrtimin e dokumentacionit të dërguar prej nesh dhe të vendosë nëse është apo jo i rregullt ky dokumentacion përpara se të miratojë kërkesën e shkollës për nxënësit përfitues të bursës së plotë për vitin shkollor 2024-2025.*
 - *Interesi më i lartë i fëmijës është në themel të punës sonë institucionale dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë të gjitha mundësitë tona për të ndihmuar familjet në nevojë të përfitojnë bursën e plotë, duke garantuar ndihmesën tonë në zgjidhjen e problematikave të komunitetit të prindërve.*
5. Në vijim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti ankues, nëpërmjet email-it të datës 16.12.2024, ka paraqitur para Komisionerit kërkesën për tërheqjen nga ankesa e saj, pasi konsideron se ajo mori zgjidhje. Ankuesja ka konfirmuar se kërkesa për pranimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës së fëmijës së saj, nga ana e Shkollës, ishte realizuar me ndërmjetësimin e Komisionerit dhe se e konsideron të përmbushur qëllimin për të cilin kishte paraqitur ankesën pranë KMD-së.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga

² Administruar pranë Komisionerit me nr.1446/3 prot., datë 06.11.2024.

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.1446/4 prot., datë 06.11.2024.

Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 210 Regj., datë 22.10.2024, të paraqitur nga znj.E. D,e cila përfaqëson në këtë ankesë djalin e saj të mitur E. D, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA